

VENDIM
Nr. 685, datë 2.9.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDACIONIT “FUNDJAVË NDRYSHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore’”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe fondacionit “Fundjavë ndryshe”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Nr. Prot

Tiranë, më __. __. 2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE FONDACIONIT “FUNDJAVË
NDRYSHE” PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS
FATKEQËSISË**

Sot, në datën . . 2020, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
dhe

Fondacioni “Fundjavë ndryshe”, person juridik i regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 534, datë 1.12.2015, me NUIS L 61315453U, me seli në adresën: Rruga e Arbrit, Tiranë, Shqipëri, i përfaqësuar ligjërisht nga z. Arbër Hajdari, i biri Shkëlqimit dhe i Marjanës, lindur më 16.2.1994, shtetas shqiptar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J40216055N, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar më poshtë si “Donatori”, të cilëve bashkërisht iu referohet si “Palët” dhe secilit prej tyre si “Pala”.

Duke qenë se:

A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, dhe me vendimin nr. 751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, është përfshirë dhe qarku Lezhë.

B. Ligji nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse, si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta, të cilat nëpërmjet donacioneve të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.

C. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë, vendës ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme në natyrë, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.

D. Kjo marrëveshje bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e Projektit, në funksion të procesit të rindërtimit në territoret e zonave të prekura në Bashkinë Tiranë, në masën 1 000 000 (një milion) euro, sipas kërkesës për nevojë të bashkisë përfituese (njësia e vetëqeverisjes vendore) si më lart (referuar në vijim si “Projekti”), sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Palët, në referim të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj marrëveshjeje është realizimi i punimeve për ndërtimin e banesave individuale dhe çdo gjë tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave, sipas propozimit të Donatorit dhe bazuar në kërkesës për nevojë të Bashkisë Tiranë.

1.2 Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, detyrën e njësisë zbatuese për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve për ndërtimin e banesave individuale dhe çdo gjë tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave, sipas propozimit të Donatorit do ta kryejë Bashkia Tiranë.

Neni 2

Masa e donacionit

2.1 Masa e donacionit, sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, është në vlerën 1 000 000 (një milion) euro.

2.2 Donacioni, sipas kësaj marrëveshjeje do t’u nënshtrohet të gjitha parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1 Bashkia Tiranë do t’i garantojnë Donatorit një truall të përshtatshëm me sipërfaqe të mjaftueshme, në kuadër të zbatimit të Projektit.

3.2 Midis Donatorit dhe bashkisë përfituese do të lidhet një marrëveshje bashkëpunimi.

3.3 Projektet e zbatimit për objektin e marrëveshjes së bashkëpunimit do të hartohen nga Donatori, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, do të miratohen nga Palët me konsensus të përbashkët. Zbatimi i Projektit do të bëhet nga vetë Donatori. Kostoja e ndërtimit të banesave dhe vlera e Projektit do të llogaritet duke marrë për bazë projektet e miratuara.

3.4 Lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit do të nxirren nga autoritetet përgjegjëse në bashkëpunimit me bashkinë përfituese të Projektit.

3.5 Normat e projektimit dhe të zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.

3.6 Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe të VKM-së nr. 354, datë 11.5.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të realizohen nga Bashkia Tiranë dhe vlera e këtyre shërbimeve do të financohet nga programi i rindërtimit.

3.7 Kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët për realizimin e Projektit do të përzgjidhen nga Donatori.

3.8 Bashkia Tiranë do të marrë përsipër të garantojnë vendosjen në dispozicion të Donatorit të sheshit të ndërtimit, si dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për realizimin e Projektit.

3.9 Në lidhje me parcelat, truallin ku do të kryhen punimet, dorëzimi i shesheve të ndërtimit do të bëhet nga Bashkia Tiranë. Të gjitha lejet e nevojshme, me qëllim realizimin e këtij Projekti, do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, nëpërmjet Bashkisë Tiranë.

3.10 Të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me palët e treta që gjenden brenda sheshit të ndërtimit (shpronësimi, nxjerrja e njerëzve nga godinat në përdorim, shembja e objekteve, të gjitha përgjegjësitë ligjore ndaj personave që detyrohen të dalin nga sheshi i ndërtimit, si pasojë e zbatimit të Projektit) i takojnë Bashkisë Tiranë.

3.11 Donatori, sipas kësaj marrëveshje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.

3.12 Në përfundim të realizimit të Projektit, Donatori përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të Projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave, i cili me vendim i kalon objektet e reja në pronësi të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Bashkisë Tiranë.

3.13 Të gjitha procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të Projektit, do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga Bashkia Tiranë.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Pale dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim dhe do t'i dërgohet dorazi ose me postë rekomande në adresat e mëposhtme:

Fondacioni “Fundjavë ndryshe”:

Adresa: Rruga e Arbrit, Tiranë, Shqipëri

Email: fundjavëndryshe@gmail.com

Çdo njoftim ndaj pranuesit të donacionit do të adresohet te:

Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë

<https://rindertimi.gov.al/>

Email: Sekretariati.Rindertimi@kryeministria.al

Çdo ndryshim i adresës së njërës Palë do duhet t'i njoftohet me shkrim Palës tjetër.

Neni 5

Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve, në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 7
Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën në lidhje me realizimin e Projektit do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato te një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8
Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

Për sa më sipër, të nënshkruarit kanë nënshkruar kontratën në 4 (katër) origjinalë.

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020

MINISTRI I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
Arben Ahmetaj

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020

DONATORI
FONDACIONI “FUNDJAVË NDRYSHE”
Z. Arber Hajdari